



PROCESVERBAL 7 /2025

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 7 (shtatë) për vitin 2025 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi:	Suharekë
Zyra:	Salla e Kuvendit të Komunës
Data:	23.07.2025
Ora:	10:00

Prezentë në takim:

Z. Shefket Kolgeci	Z. Vullnet Luzhnica	Të pranishëm tjerë
Z.Selman Kolgeci	Z.Edon Sadikaj	Kryetari Komunës
Z. Flamur Bytyçi	Znj.Saranda Bajraktari	Media dhe qytetarë
Z. Urim Suka	Znj.Mimoza Bajraktari	OSCE, LMT, KDI
Z. Kushtrim Kuçi	Znj.Festë Kabashi	Znj.Habibe Bytyqi
Znj. Elmaze Bytyqi	Z.Dardan Berisha	Z.Xheladin Sadikaj
Znj. Bulëza Kuçi	Z.Bajram Basha	
Znj.Doruntina Zenelaj	Znj.Mevlude Kabashi	
Z.Alban Berisha	Znj.Sheqerije Zyrapi	
Z. Xhevshet Gashi	Znj.Laureta Tafaj	
Znj.Sanie Kuçi- Rexhepaj	Z.Liridon Fandaj	
Z. Bexhet Kuçi	Z.Qëndrim Elshani	
Z. Reshat Selimaj	Znj. Afërdita Morina	
Z. Lirim Qatani	Z.Herolind Limaj	
Z. Aziz Bytyqi	Znj.Jehona Lumi	
Znj.Fidaije Kukaj	Rrafshi	

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi,i cili propozoi këtë:

REND DITE

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar ;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2024,të komisionit komunal të aksionarëve të NPL „Stacioni i Autobusave“ SH.A. ;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e THV 2023 dhe THV 2024 të pa shpenzuara gjatë viti fiskal 2024 të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025 ;**
4. **Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës ;**
5. **Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2025 ;**
6. **Raporti i parë gjashtëmuor për mbikqyrjen e kontratave të pronës;**
7. **Pyetje dhe përgjigje;**

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet rendi i ditës

Pika 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1.

Unanimisht Miratohet Pika 1

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e raportit për vitin 2024, të komisionit komunal të aksionarëve të NPL „Stacioni i Autobusave“ SH.A. ;

Liridon Fandaj - kisha dasht që komisioni ose ndonjë anëtar i komisionit me paraqit raportin e pastaj ne me diskutu këtë çështje.

Xhevxhet Gashi - i informon të pranishmit sa i përket raportit të punës së Komisionit Komunal të Aksionarëve të NPL „Stacioni i Autobusave“ Sh.A. Ky komision ka mbajtur 6 takime të rregullta.Ne si anëtar të komisionit jemi angazhuar në çështjen e licencimit edhe pse të gjitha kushtet paraligjore janë të plotësuara.Stacioni i autobusave nuk është licencuar për shkak se nuk e ka të zgjidhur problemin e pronës dhe nuk ka mundur të marrë masa ndaj operatorëve ekonomikë.Gjatë vitit 2024 e ka përcjell një periudhë jo e mire e financimit.Kjo ndërmarrje punon e vepron vetëm me buxhetin vetanak.Stacioni i autobusave numëron 14 punëtor të rregullt.Të hyrat për vitin 2024 kanë qenë 137,742.26€,të hyrat nga qiraja kanë qenë 8,867.77€,TVSH nga të hyrat 21,011.55€,fitimi në bruto 116,830.71€,materiali 1,559.69€,shpenzimet e zyrës 1,240.50€,shpenzim në inventar 258.20€,derivate 640€,posta e telefonit 356.12€,keku 2,562.03€,të ardhurat e punëtorëve në ATK janë 101,167.33€,veshmbathje e punëtorëve 1,116.50€,taksat komunale 700€,servisimi i arkës është 264.75€,tatimi në burim 6,783.04€,kontributet e punëtorëve 5,573.43€,dhuratat 60€,mbeturinat 600€,TVSH në shpenzim 1,072.38€,etj.

Liridon Fandaj - në KPF unë kam kërku raportimin e pasqyrave financiare që është bërë në këshillin për raportim financiar ose pasqyrat financiare që janë raportu në ATK dhe i njeiti dokument nuk është sjell por në bazë të kësaj që është sjell si pasqyrë financiare,këtu del që Stacioni i autobusave ka më pak të hyra dhe është me humbje.Cila është arsyeja që kanë rënë të hyrat dhe gjeneron me humbje

satcioni i autobusave?Lokalet që janë brenda stacionit të autobusave prej kujt menaxhohen,kush e inkason qeranë dhe a është pronësi e stacionit apo është pronësi tjetër?Te pjesa e asaj që nuk ka mundur të licencohet,ne me Drejtorin e Katastrës disa herë e kemi repliku dhe ai na ka thënë që e ka zgjidh një problem i cili nuk është zgjidh tash e sa kohë.Për deri sa u zgjidh një problem,cila është arsyeja për mos licencim?

Kryesuesi - ne në KPF e kemi diskutu që raportit i ka munguar pasqyra financiare përfundimtare për vitin 2024 dhe dje na ka sjell Xhevdeti.Unë ia kam përcjell me email dhe pak a shumë është kjo gjendja.Kurse për pjesën tjetër sa e di unë është e licencuar.

Liridon Fandaj - e kam marrë në email atë dokument por unë kam kërku pasqyrat financiare në detaje dhe nga fillimi i mandatit jam duke i kërku këto pasqyra financiare.Mos të vimë në një pikë, që një ditë ndoshta Kuvendi Komunal duhet me financu për obligime të stacionit të autobusave.Edhe pse në atë pasqyrë janë paraqit pjesa e shpenzimeve,aty nuk janë as asetet e as pjesë tjera që shkojnë në fazë të amortizimit dhe të vlerësimit.

Xhevxhet Gashi - ne gjatë periudhës 2024 kemi pas edhe ngritje të pagave dhe për shkak të ngritjes së pagave është ngrit edhe puna,por në anën tjetër puna ka ra sepse shumë operatorë kanë mbyll dhe për shkak të moslicencimit nuk mund të marrim masa pak më radikale për me hy ata në stacion sepse ata nuk e shfrytëzojnë stacionin e autobusave.Ka katër vite që bëjmë kërkesë rreshatzi dhe Armendi e ka kryer problemin e pronës dhe tash në fund ka ardhë licencimi.

Kryesuesi - a është licencu stacioni tash?

Xhevxhet Gashi - po është licencu.

Urim Suka - në KPF kemi dhënë shumë vërejtje për raportin fillestar dhe kemi kërku sqarime shitesë sepse në atë raport nuk i kemi pas gjërat e qarta.Tash kemi marrë një pasqyrë pak më të detaizuar dhe e kemi pak më të qartë.Informata që stacioni i autobusëve është licencu po na gëzon edhe pse në dokumentet zyrtare dhe në këtë raport po figuron që ende nuk është licencu mirëpo shpresoj që vendimi është ashtu si po thuhet dhe nuk surprizohemi me diçka.Liridoni përmendi disa shqetësime lidhur me lokalet që janë aty dhe unë mendoj që komisioni duhet me i marrë veprimet e nevojshme që asgjë mos me qenë në dëm të interes publik dhe të stacionit aty.U tha që është një humbje e vogël në krahasim me të hyrat dhe të dalurave dhe kjo na shqetëson sepse gjithmonë duhet ta ketë parasysh që në kuadër të hyrave stacioni duhet me punu në atë drejtim që me mujt me menaxhu veten e ndoshta edhe me kriju për të ardhmen,për zhvillimin e stacionit.Ndoshta si qeverisje komunale është dasht me punu më shumë që stacioni me qenë më modern dhe me i ofru kushte qytetarëve më shumë.Duke u marrë për bazë të gjitha që u thanë dhe duke marrë për bazë edhe pasqyrën financiare që ka ardhë,me vërejtjet eventuale që janë,ne mendojmë ti japim votën këtij raporti me idenë që raportet tjera të jenë edhe më sakta dhe të qarta.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

24 për,3 apstenime,Miratohet pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për bartjen e THV 2023 dhe THV 2024 të pa shpenzuara gjatë viti fiskal 2024 të barten për shpenzim në vitin fiskal 2025 ;

Kryesuesi - e e laboron pikën dhe hap debatin.

Labinot Halitjaha - këtu është bartja nga viti i kaluar prej vlerës 103.287€ ku janë të ndara në kategori.Bartja nga viti i kaluar bëhet nëpër kategori të veçanta ashtu siq janë në kategori.P.sh. nëse janë mallra dhe shërbime,barten direkt në mallra dhe shërbime.

Urim Suka - pak u surprizova nga përgjigjja e drejtorit.Ishte shqetësimi në KPF dhe drejtori nuk më dha përgjigje dhe tash më duket një lloj përgjigje e atij shqetësimi që e kam ngrit në KPF,veq mos t'ka çka me thane Urimi.Është mire me theksu që përveç këtij vendimi që e kemi përpara për bartje,ne në fund të janarit për këtë vit e kemi miratu një vendim tjetër për bartje,ku janë bart 701.000€.Kjo na shqetëson edhe për faktin që ka qenë një vit ku përmbauesit i kanë ataku shumë projekte ku janë marrë shumë pare dhe komuna ka pas shumë probleme në menaxhimin e projekteve. Gjithë këto probleme që i ke pas me projekte për me i pagu,e në anën tjetër të hyrave vetanake nuk i keni kushtu rëndësi shumë dhe ju kanë mbet para pa shpenzu.Ne e dime që secilin vit është e natyrshme me mbet disa mjete dhe me u bartë nga viti në vit.Drejtori nuk e di sa e ka të sinqertë atë përgjigje por besoj që ndoshta është edhe ashtu.Mua më ka shqetësu fakti edhe në KPF dhe më shqetëson edhe sot dhe ndoshta kjo është një arsye pse ne sot do ta apstenojmë si projekt-vendim sepse te investimet kapitale

po barten vetëm 7.436€ kur ne e dime se sa shumë probleme ka prap edhe këtë vit me përmbaues. Ndoshta është dasht me mendu variantin më të mirë brenda mundësive ligjore që ju mund të keni, që çdo lloj bartje që do ta bëjmë, nëse është e mundshme, me i qu te investimet kapitale. Ne për shkak të disa shqetësimeve do ta apstenojmë këtë projekt-vendim.

Labinot Halitjaha - tash jemi në kohën e fushatës dhe e di që të gjitha diskutimet kanë me qenë pak a shumë reklamë për subjektin ose për veten. Këtu të gjitha të hollat që janë bartë janë nëpër kategori dhe janë një pjesë e vogël që kanë mbet nëpër projekte dhe nuk është ndonjë vlerë shumë e madhe ashtu siç e diskutove. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - shqetësimin që unë e ngrita rreth investimeve kapitale që janë vlerë shumë e vogël këtu, është edhe si rezultat i përgjegjës që ju ma keni dhënë në KPF kur unë kam pyet se pse janë kaq pak ose nga kanë mbet këto para. Ju keni thënë që shumica kanë mbet nga investimet kapitale dhe tash këtu e keni ndërru përgjegjën. Sa i përket punës që jemi në fushatë zgjedhore, ju krejt e dini sa here kam fol për vendimin për bartje, gjithmonë kam qenë më agresiv se sa sot dhe nuk po bëj fushat elektorale.

Qëndrim Elshani - bartja e mjeteve të pa shpenzuara nga të hyrat vetanake 2023-2024 për vitin 2025 është një dështim në realizimin e planifikimit vjetor të buxhetit. Është shqetësuese që një shumë e madhe nga të hyrat vetanake të planifikuara për t'u shpenzu në vitin 2023-2024 nuk janë realizu. Kjo tregon mangësi serioze në planifikim dhe ekzekutim të buxhetit nga ana e ekzekutivit dhe njesive buxhetore. Mosshpenzimi i mjeteve nënkupton që shumë shërbime, projekte e subvencione nuk janë realizuar në kohë, duke i lënë qytetarët pa shërbime të nevojshme. Bartja duhet që mos ta prish strukturën e ndarjeve buxhetore. Megjithatë, vet vendimi tregon se këto mjete po shkojnë në mbulimin e obligimeve të grumbulluara nga gabimet e planifikimit e jo në projektet e rëndësishme për qytetarët. Nëse çdo vit lejojmë që mjetet të mos shpenzohen dhe të barten vitin tjetër, atëherë procesi buxhetor humb funksionin e vet zhvillimor dhe afatshkurtër, andaj unë ju ftoj të gjithëve që kjo pikë të mos kalohet pa u dorëzuar në Asamble një raport i detajuar me arsyet e mosshpenzimit për secilën njesi buxhetore dhe pa u përcaktuar një plan konkret i shpenzimit për çdo shumë të bartur.

Fadil Hoxha - ZKF jep sqarime sa i përket bartjes së mjeteve të pa shpenzuara 2023-2024 për vitin 2025.

Urim Suka - unë ka e dëgjova Fadilin e kuptova një detaj që mund të jetë gabim teknik. Tha që te mallra dhe shërbimet, te zyra e Kryetarit kanë qenë 1.000€ dhe totali 25.000€ ndërsa unë këtu përpara e kam 4.800€ dhe totali 36.000€. Nëse ka harru Fadili diçka me thanë, le ta plotëson në aspektin teknik. Ne e kemi kërku këtë sqarim që e dha Fadili prej Drejtorit të Financave që s'ka marrë mundin me bë. Nëse ajo që dëgjova unë është e vërtetë, i bie që ne kemi me votu tjetër gjë e realiteti është tjetër gjë, te kategoria mallra dhe shërbime. Pjesa tjetër që secila komunë ka bartje dhe ka me pas gjithmonë, ne e dimë por kur kemi qenë ne në pushtet na keni kritiku për 350.000 dhe për atë ne po ua kthejmë.

Fadil Hoxha - unë e thashë dhe ashtu është por pjesa që kanë mbet të vogla dhe nuk mund ti vendos 20€, 50€ dhe 200€, ne i kemi bart te zyra e Kryetarit me arsyetimin që e ka pas obligimin dhe kam mund ti vendos të gjitha me një mirëpo struktura e shpenzimeve nuk guxon me lujt.

Flamur Bytyçi - në arsyetim po e shoh që vlera prej 59.000€ shkon për vendime përmbaimore. A dihet sa është vlera që kemi pagu ne deri sot për vendime përmbaimore dhe a mund ta dimë ne që me këto 59.000€ cilat vendime po i paguajmë ne?

Labinot Halitjaha - për të gjitha procedurat përmbaimore i kemi të sqaruara dhe i kemi diskutu me ZKF-në i cili i ka përgadit të gjitha të hollat se ku i ka marrë përmbauesi, në projekte, mallra dhe shërbime ose subvencione.

Kryetari - në vitin 2023 procedura përmbaimore kanë qenë 3.5 milion, në 2024 - 4.5 milion, para dy muajsh në 2025 - 1.1 milion dhe ka katër ditë që është blloku thesari dhe vlera përmbaimore pritët të jetë 1.7 milion. Sa kanë me marrë, unë nuk e di.

Liridon Fandaj - ne e kemi kërku në KPF këtë raport me na ardhë dhe sot me u përgadit, dhe po atë ditë ke mujt me na përcjell drejtor e ne sot me diskutu. Dua të lidhem te pjesa e Qëndrimi që e tha për punë të shpenzimeve dhe për bartjen që po bëhet shpesh. Është e vërtetë që të gjitha komunat tjera kanë por ne nuk do të thotë me marrë shembull një komunë që ka dështu në planifikim. Komuna jonë nuk ka dështu vetëm në shpenzimin e të hyrave vetanake por ka dështu edhe në shpenzimin e granteve qeveritare dhe kjo është më e dhimbshme sepse ato mjete shkojnë në komuna tjera. Nëse ZKF do ta mbroj pushtetin, është dasht të bëhet drejtor por jo ZKF sepse drejtori nuk po e mbron pushtetin. Bartja e të hyrave në 2023-tën, ka dështu, bash në ato projekte që ne i kemi bart.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

13 për, 5 kundër, 10 apstenime, Miratohet pika 3

Reshat Selimaj - Unë sot personalisht kam vendosur të tërhiqem nga grupi parlamentar i AAK-së. Aktiviteti im do të vazhdoj me LVV-në dhe në grupin e tyre dhe po ashtu në mbështetje të Kryetarit Hamdi Bytyqi. Unë i falemderoj të gjithë kolegët për këto 12 vite, posaqërisht juve Kryesues dhe shefin e gr. Parlamentar për bashkëpunimin.

Aziz Bytyqi - e falemderoj Reshatin për bashkëpunimin dhe korrektësinë dhe të uroj suksese e shëndet kudo që je.

Afërdita Morina - edhe unë dua të ju njoftoj se prej sot nuk jam pjesë e AAK-së dhe aderoj në PDK. I falemderoj të gjithë asambleistët për bashkëpunimin që kemi pas.

Aziz Bytyqi - jemi në demokraci, në të drejtën tuaj dhe ju uroj shëndet e suksese gjithmonë.

Laureta Tafaj - i urojmë mirëseardhje kolegut Reshat Selimaj dhe besoj që kemi me pas përvojë të mirë bashkë dhe me vazhdu sëbashku.

Dardan Berisha - kolegës Afërditës i urojmë mirëseardhje në grupin asambleist të PDK-së dhe me vizionin e PDK-së dhe gjithësesi Reshatit i dëshirojmë rrugëtim të mbarë në subjektin e VV-së.

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për bonuset e zonimit për Komunën e Suharekës ;

Kryesuesi - duke u bazuar në kërkesën e bizneseve të Suharekës, unë u obligova që këtë projekt rregullore ta sjell përsëri në Kuvend për diskutim. Duke u nis nga parimi që këto biznese të cilat kanë bërë kërkesë janë biznese jashtëzakonisht të mira dhe janë taksapagues më të mirë në nivel të RKS, kërkoj që ta kemi në konsideratë kërkesën e tyre. Hap debatin.

Liridon Fandaj - ne në KPF nuk e kemi pas kërkesën e këtyre bizneseve por për Asamble na ka ardhë kërkesa me nënshkrime të atyre bizneseve. Kërkesa e tyre nuk ka lidhje me projekt-rregulloren. Ata kërkojnë për një rregullore për shpronësim dhe kjo rregullore nuk është për shpronësim por është për bonus zonime. Nëse dikush nga ekzekutivi ia ka përpiluar atë, nuk i ka ndihmu as atyre po as rregullores në fjalë. Pjesa tjetër është që po e kërkon votën dhe po bëni presione ndaj kolegëve asambleist për me votu këtë rregullore e cila nuk ka pësuar asnjë ndryshim prej herës së parë. Nuk janë marrë në konsideratë kërkesat tona dhe nuk na ka ftuar askush. Do të ishte mirë që ti si Kryesues dhe Kryetarit, ditën kur ju ka ardhë kërkesa me na ftuar edhe neve si subjekte politike dhe m'u taku me ato biznese dhe me ia sqaruar. Disa prej tyre më kanë kontaktuar edhe mua dhe nuk e dinë çka përmban rregullorja. Ne kemi kërku që në rregullore mos t'i hiqet e drejta e komisionit brenda Asamblesë. Ne jemi pro bizneseve por nuk jemi pro pazareve të askujt. Nëse Drejtori për Urbanizëm Asamblesë e kaluar ka thënë që do t'ju ftoj, dhe do të bëjmë një ndryshim, ai asnjë hap nuk e ka marrë. Sot jemi para një akti ku bizneset mendojnë që ne jemi kundër bizneseve ose kundër qytetarëve. Më së paku kemi interes që mos me kalu një rregullore por të paktën të ajo rregullore të mirren vërejtjet tona që janë në favor edhe për bizneset por edhe për qytetarët. Nëse doni me kalu këtë rregullore, ka kohë ende. Ulemi, diskutojmë dhe i heqim vërejtjet që i kemi ne. Në kuadër të kësaj kërkoj të di nga zyrtari i gjor që nëse ndonjë anëtar i Kuvendit sot e voton këtë rregullore dhe ka lidhje direkte me biznesin që ka bërë kërkesë, a është konflikt interesi dhe a duhet me shku kjo në agjensionin antikorruption?

Avni Bytyqi - është ligji për vetqeverisje lokale i cili i obligon të gjithë anëtarët e Kuvendit të cilët dyshojnë se kanë konflikt interesi në afërsi me familjarët dhe me anëtarët e familjes së ngushtë deri në shkallën e 4-të në vijë të tërthortë. Ligji për parandalimin e konfliktit të interesit specifikisht e thotë: kur një zyrtar publik dyshon apo ka hy në konflikt interesi është i obliguar që ta paralajmëron konfliktin e interesit të organi epror dhe organi epror konstaton a ka apo nuk ka konflikt interesi. Nëse zyrtari publik nuk bindet që ka konflikt interesi pavarësisht sqarimit dhe interpretimit nga eprori, atëherë çështja shkon në agjensionin kundër korrupsion dhe ata vendosin për këtë çështje. Secili që dyshon që ka konflikt interesi me cilën do firmë që është e parashtrunë në kërkesë, ju kisha sugjeru që ta paralajmëroni konfliktin e interesit, përndryshe mund të keni pasoja ligjore.

Selman Kolgeci - sot si grup i asambleistëve të LDK-së në Kuvendin e Komunës së Suharekës e ndiejmë obligim publik të sqarojmë qytetarët e në veçanti ndërtuesit në qytetin tonë dhe pronarët e pronave që me HZK iu lejohet ndërtimi i lartë, të sqarojmë pozicionin tonë lidhur me rregulloren e bonusit të zonimit që është propozuar për votim. Ne nuk jemi kundër rregullores, ne kërkojmë

përmirësimin e saj. Në mbështetje të një rregullore funksionale dhe të dobishme e cila ndihmon zhvillimin urban të qytetit, lehtëson investimet dhe ndihmon zbatimin e HZK-së. Ne e kemi dëshmuar këtë me veprimet tona konkrete siq janë: votimi i dokumenteve të Planifikimit Hapsinor, përfshirë shumë dokumente strategjike që kanë dalë nga PZHK-ja dhe nga HZK-ja e shumë plane të hollësishme rregulluese, projekte e iniciativa të shpalljes së shumë vendeve si interes i përgjithshëm dhe do të ju kujtojmë juve dhe bizneseve që jemi ne ata që dy herë e kemi sjell në Kuvend vendimin për lirim nga taksa komunale në aktivitet për bizneset tona. Andaj etiketimet ndaj neve se LDK-ja është bllokuese dhe se asambleistët e LDK-së janë bllokues, janë etiketime të pandershme, të papranueshme dhe me tendencë që ta dëshmojnë imazhin tonë pa fakte, pa argumente dhe mosmirënjohës për kontributin në shumë pika që i kemi vlerësuar se janë interes i përgjithshëm i qytetarëve dhe zhvillimit të qytetit. Andaj qëndrimi ynë nuk është në kundërshtim ndaj kësaj rregullore por ndaj një verzioni të papërmirësuar që ka defekte ligjore, teknike dhe nuk i shërben interesit publik. Është pushteti ai që po e bllokun miratimin e kësaj rregullore. Sot pushteti aktual po tregohet i pavullnet për ta përmirësuar këtë rregullore pavarësisht se ne kemi ofruar kritika konkrete me argumente për të ndihmuar procesin. Kërkesat tona janë të bazuara në mbrojtjen e interesit publik, respektimin e ligjshmërisë dhe barazisë, shmangjen e centralizimit të vendimmarrjes duke ruajtur kontrollin demokratik të kuvendit me përfshirjen e kuvendit si pjesë e komisionit. Kërkesat tona për ndryshime janë të qarta. Te neni 6 pika 2 bonuset e zonimit mund të aplikohen në të gjithë zonën ndërtimore të përcaktuar me dokumentin e PZHK-së dhe HZK-së dhe këtë rregullore e thotë si në vijim: po kjo pikë nuk është e plotësuar sepse nuk ka shpjegim se si vijon tutje. Do të duhej të ishte bashkë me pikën 3 të këtij neni dhe pika 3 e kësaj rregullore të hiqej komplet nga ky draft. Neni 6 pika 5.2 Zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijës ndërtimore. E kemi theksuar edhe herën e kaluar që vija ndërtimore nuk ka kuptim me u deviju sipas këtij neni, mund të ketë shkaqe tjera teknike në teren por jo në këtë formë. Neni 5.6 Rritja e lartësisë; Sipas kësaj rregullore tenton me u rrit lartësia e ndërtesës në përqindje. Kriteri teknik i shprehur në këtë formë nuk është i pranueshëm dhe është i dëmshëm, madje edhe mënyra e të shprehurit në pjesën tekstuale dhe në formulë tregon se formula dhe pjesa tekstuale nuk janë të harmonizuara në mes vete. Ne propozojmë që të plotësohet dhe të ndryshohet ky nen: a: në rast të plotësimit të kriterëve tjera për zonat ZB3, ZB4, ZSHP3 dhe ZSHP4 ti jepet mundësia e shtimit të vetëm një etazhi. Në rast të plotësimit të kriterëve tjera për zonën ZB5, ZSHP5 ti jepet mundësia për shtim të vetëm një etazhi dhe kati i tërhequr të jetë opsional. Te neni 7: Formimi i komisionit për shqyrtimin e kërkesave duhet të jetë vetëm një komision. Mund ti japim të drejtë atij komisioni se në rast të volumit të punëve të marrë ndihmës por raportet kanë të drejtë të nënshkruaj vetëm ky komision dhe askush tjetër. Pika 3 e këtij neni mbi përmbajtjen e komisionit në pikën 4.1 të shtohet: apo përfaqësues nga Oda e Arkitektëve e RKS-së dhe anëtar të Kuvendit. Të ketë kryesues komisioni zyrtarin përgjegjës të ngarkuar me lëndë; Të hiqet pjesa e dytë e nenit 4 ku i jepet e drejta Kryetarit për formimin e komisionit atëhok për vlerësim; Të hiqet pika 5 e këtij neni pasi që është e lidhur me pjesën e dytë të pikës 4. Te neni 8 Procedurat e aplikimit për bonuse të zonimit : konsiderojmë që pikën 2.4 Harta e Zonës ose projekti për zhvillim. Pika 2.7 Vlerësimi i ndikimit mjedisor të projektit ; Pika 2.8 Vlerësimi i infrastrukturës publike për zhvillim; Pika 2.9 Plani i menaxhimit të projektit; Pika 2.10 Dokumentacion që përcakton kriteret e lejuar në përputhje me dokumentet e planifikimit hapsinor; Ne konsiderojmë që këto pika duhet me u heq sepse është ngarkesë për palët.

Të dashura biznese, ne kemi pranuar peticionin e juaj të detajuar, e kemi trajtuar kërkesën tuaj. Suhareka si vend i inxhinierëve, arkitektëve e ndërtuesve më të mëdhenjë në nivel vendi, këtë temë duhet me trajtu me dinjitet. Pushteti tash e 4 vite e kanë pas mundësinë me hartu një rregullore të tillë e s'kanë mujt me hartu. Këta tash viktimizohen se kinse LDK-ja s'don me kalu këtë dokument por besoni që nuk dinë me hartu rregullore dhe nuk dojnë me hartu rregullore të shëndetshme. Ne duke trajtuar këtë rregullore pikë për pikë, me propozimet që i dhamë, ju tregojmë se jemi pro kësaj rregullore por të pastër, të arsyeshme, të padëmshme për asnjërën palë pëfituese. Andaj të dashur biznese, nëse propozimi jonë nuk kalon, i propozoj Kryetarit që të thërras sot të gjithë asambleistët sëbashku me gjithë ju të nënshkruarit, ta mbajmë një diskutim të përbashkët, ti qesim të metat e këtij dokumenti, të hartojmë një dokument si i ka hije e të thërrasim një seancë të jashtëzakonshme ashtu si ju keni kërkuar dhe të miratojmë këtë rregullore si i ka hije qytetit tonë.

Sanie Kuçi Rexhepaj - Rregullorja për bonuset e zonimit po vjen për herë të tretë dhe ne si grup për herë të tretë po i adresojmë të njëjtat çështje që nuk janë marrë për bazë deri më tani. Ne nuk jemi kundër konceptit të bonuseve, përkundrazi i shohim si mjet të dobishëm për të orientuar zhvillimin

urban në mënyrë të kontrolluar por nuk mjafton të jemi pro konceptit,duhet të jemi pro përmbajtjes.Janë disa pika përmbajtësore që përmendi edhe Selmani dhe dua që përmes sqarimit tim me plotësi dhe me kuptu edhe më mirë.Janë disa pika përmbajtësore që nëse nuk rishikohen,e bëjnë të pamundur për ne që ta japim votën pro.Ja tri elemente kyqe brenda rregullores dhe po i analizojmë bashkë një nga një.Neni 5.2 Zvogëlim të kërkesave për tërheqje të vijës së ndërtimit mund të tolerohet deri në 10% të asaj që është përcaktuar me HZK-në.Vija e ndërtimit është një vijë imagjinare që përcakton ku fillon ndërtimi i objektit karshi rrugës.Nëse e kemi rrugën dhe ka me fillu një objekt i ri me u ndërtu,HZK e ka përcaktuar,p.sh. objekti ka me fillu ndërtimin 7 m larg rrugës.Kërkesa për ta zvogëlu vijën e ndërtimit,në thelb krijon padrejtësi urbanistike.Pse? nëse ne dikujt sot po i lejojmë me shkel vijën e ndërtimit,sot po e zhvlerësojmë dikë që ka ndërtu dhe e që nuk ka qenë përfitues i bonuseve në ndërtim sepse në një objekt ekzistues që u ndërtu më herët pa pas përfitim në bonuse të zonimit,i del sot përpara një objekt i ri dhe ky objekt i ri ka me i kriju hije objektit ekzistues,ka me ja zbeh pamjen dhe ka me i kriju konkurrencë të padrejtë në qasje dhe përfitim.Urbanizmi nuk është një garë se kush po përfiton më shumë bonuse në zonim dhe kush kujna po i del përpara.Urbanizmi është drejtësi hapsinore,është balancë vizuale,është rregull për të gjithë,andaq mundësia e zvogëlimit të vijës ndërtimore apsolutisht nuk duhet me qenë pjesë e kësaj rregullore. Neni 5.5 Rritja e përqindjes së sipërfaqes së shfrytëzueshmërisë së shputës në raport me parcelën ndërtimore investitorit mund të tolerohet maksimumi deri në 10% të asaj që është përcaktuar me HZK.Si interpretim është:sa metra katrorë i lejohen investitorit me rrit bazën e objektit.Në ditët e sotme ne po e kemi jashtëzakonisht të vështirë me siguru hapësira për parking,gjelbrim të nevojshëm e çka është më thelbësore po e kemi të nevojshme me i siguru rrugët që janë thelbësore për emergjenca e për jetën e përditshme të banorëve në ato objekte.Duke lejuar rritje të pjesës së objektit që e prek tokën,ne në fakt po e marrim edhe atë pak tokë që duhet ti mbetet banorëve në shfrytëzim.Përmes bonuseve të zonimit ato metra katrorë shtesë që projektuesi i ka,le ti integrojë në lartësi dhe jo në shputë e gjerësi të objektit.Neni 5.6 Rritja e lartësisë së kateve maksimale të ndërtesës: Investitorit mund ti lejohet jo më shumë se 10% e lartësisë maksimale të përcaktuar me HZK e jo më shumë se një kat +një kat i tërhequr e cila kalkulohet duke qenë e varur nga përqindja e sipërfaqes që i merret për respektimin e vijës rregullative sipas HZK-së.Në lexim të parë është krejt në rregull.Shfletojmë Hartën Zonale dhe marrim një shembull konkret. ZB4 thotë:lartësia maksimale është 19 m,komuna po ia lejon investitorit që me rrit maksimumin 10% të 19 metërshit,ku 10% i 19 metërshit është 1.90 m dhe që praktikisht nuk i bie as një kat i plotë dhe kjo nuk ka logjikë. Kjo pikë është në kundërshtim me vetveten andaj është e parealizueshme.Kërkojmë ose të tërhiqet përqindja 10% ose të qartësohet në përputhje me standartet reale të ndërtimit.Neni 7. Formimi i komisionit për shqyrtimin e kërkesave pika 3. Komisioni duhet të përbëhet së paku prej 3 e më së shumti 5 anëtarëve dhe do të ketë këtë përbërje: Përfaqësues nga DUPM,përfaqësues nga DSHPJK,përfaqësues nga DEBF,një ekspert i jashtëm i licencuar për vlerësimin e pronave dhe zyrtari përgjegjës i ngarkuar me lëndë.Në çdo rast tjetër kur kemi të bëjmë me këmbim prone,vendimmarrja shkon përmes kuvendit dhe në këtë rast me bonuse të zonimit kemi të bëjmë me këmbim prone me metër katror ndërtim,andaq pjesë e komisionit duhet patjetër me qenë të paktën edhe një anëtar i kuvendit komunal si përfaqësues.Kjo nuk është për të ndaluar punën e askujt por për të garantuar që vendimmarrja për çështje të ndjeshme të bëhet me përgjegjësi të përbashkët.Të nderuar anëtar të Kuvendit,jasht anës ligjore e përmbajtësore të kësaj rregullore më duhet të them dhe një gjë.Si Sanie,që nga dita e parë e angazhimit tim publik kam qenë gjithmonë e gatshme që njohuritë e mia në lami të përkatëse ti përkthej në kontribut ndaj qytetarëve. Më duhet të them që propaganda që shitet në qytet e lajme të sponzorizuara për deformim të së vërtetës se LDK po e bllokoi dhe nuk po e voton një rregullore në interes të investitorëve e pronarëve të tokave,lakohen edhe emra të përveqëm nga ekzekutivi në takimet me biznese dhe me qytetarë,e kam vetëm një përgjigje: Sanie Kuçi Rexhepaj nuk bëhet pjesë e pazareve dhe interesave të ngushtë të grupeve të caktuara.Nëse këto pika që ceka rishikohen dhe përmirësohen,vota jonë do të jetë pro sepse kur ndërtimi i qytetit bëhet me mendje të kthjellët,nuk cënohen ata që kanë ndërtu dhe,përfitojnë ata që kanë me ndërtu sot dhe i lihet hapësirë atyre që kanë me ndërtu nesër.

Urim Suka - duke mbështetur në plotëni fjalën e dy kolegëve të mi dhe me propozimet e tyre konkrete,unë dola sot këtu që edhe në emër të grupit të LDK-së të shpreh një keqardhje për situatën që kemi ardhë deri këtu.Shpreh një keqardhje për bizneset që janë detyru me nënshkru ndoshta një kërkesë me prurje deri këtu dhe me thënë atë që ka ndodh.Që në seancën e parë ne si LDK kemi qenë të interesuar që kjo rregullore të plotësohet,të ndryshohet dhe të bëhet e përshtatshme për ndërtuesit,për

përfituesit,për qytetarët pa e dëmtu qytetin.Që nga ajo ditë asnjë lëvizje nuk e kemi pas nga pushteti për me u ulë me diskutu,me analizu dhe këto vërejtje m'i adresu nëse janë të drejta ose argumentet e tyre dhe me thënë që këto s'jam të drejta dhe me thënë për këto arsye nuk kaloi.Që nga ajo ditë presioni ka qenë që LDK po bllokoi.Dua ti them sot secilit qytetar,secilit ndërtues e secilit që preket nga kjo rregullore,që LDK sot në Kuvendin e komunës i ka 11 asambleist ndërsa Asambleja i ka 31.Me 11 asambleist ne në asnjë rast nuk mund ta bllokojmë këtë rregullore.Propaganda që LDK po bllokoi është qëllimkeq dhe është për mos me zgjidh këtë rregullore,madje mu m'le me mendu që ndoshta as interesi juaj nuk është për me miratu këtë rregullore.Dua të kujtoj takimin e dytë kur kjo rregullore ka ra,Drejtori i Urbanizmit e ka marrë fjalën dhe ka thënë: po e marrë mundin,pe hap një dëgjim publik për 14 ditë dhe ju ftoj juve dhe pjesë tjera të interesit,po e analizojmë dhe po provojmë me i marrë mendimet e juaja edhe po e sjellim herën e tjetër. Ajo ftesë nuk na ka ardhë kurrë.Janë dy çështje nëse s'ka ardhë ftesa:ose i keni numrat dhe sot doni me votu,ose as nuk keni interes që kjo rregullore me kalu.Propozimet e Selmanit dhe Sanies janë konkrete dhe specifike se si këtë rregullore me bo më të mirë.Ne si LDK për me kallzu këtë gadishmëri që nuk jemi bllokues në këtë proces,nëse këto propozime bëhen pjesë e dokumentit,ne që sot e japim votën për.Nëse ju nuk keni gadishmëri as sot me ngu zanin e ekspertëve,atëherë ne nuk jemi penguesit por jeni ju ata që po e pengoni.Lus Kryesuesin që propozimet tona t'i hedh në votim.

Visar Kuçi - më erdh mirë që Sania dhe Selmani në seancën e tretë që ndoshta nuk do të ishte mirë kjo rregullore me ardhë rreshtas tri seanca,të paktën i dhanë vërejtjet e veta si profesionist.Atëherë kur është miratu HZK shikoni në faqen 280 tekstuale ku shkruan që duhet të miratohet një rregullore e bonuseve.Në këtë pjesë të këtij dokumenti e kemi edhe zvogëlimin e e vijës ndërtimore,zvogëlimin e Shputës,zvogëlimin e dimensioneve minimale dhe lartësinë.I vetmi anëtar kam qenë politik.Më së paku këtu është përdor politikë.Është punu një rregullore e bonuseve duke dal prej HZK-së 2022-2030 dhe prej udhëzimit administrativ 08/2017 ku ka të bëjë me norma teknike.Sania elaboroj një rast të ZB4 dhe unë e kam sjell një rast të ZB5.Te ZB5 lartësia e objektot është 28 m ku momentalisht me HZK që jemi duke punu me P+7 lartësia e kateve 3.8,lartësia e përdhësës e arrin lartësinë maksimale 25 m dhe ne e kemi 28.Ky 10% jo çdo herë shërben me u fut në bonus.Momentalisht ne mundemi me shku edhe P+8 sepse e kemi lartësinë 28.Shkon proporcion me këmbimin e pronës,me maksimumin e 25% të pronës.Është fakt që kam dasht me ju thirr si asambleista edhe pse proceduralisht nëse e pyesim ekipin për këtë rregullore,ata e kanë përfundu punën e tyre.Unë si drejtor të paktën kam dasht m'i thirr shefat e grupit por me kërkesën e bizneseve Kryesuesi dhe Kryetari e kanë pa të rrugës me sjell edhe një herë.Pjesa tjetër e vijës ndërtimore,jo çdo herë preket vija ndërtimore.Për momentin komuna e Suharekës në etazhitetin më të lartë ZB5 e ka vijën ndërtimore 8.Kjo vijë ndërtimore në proporcion me lartësinë e objektit kur të arrin në lartësinë 20 m,kjo vijë ndërtimore duhet me u tërhek.Drejtori tutje jep sqarime sa i përket bonuseve të zonimit.

Selman Kolgeci - po thotë që te ZB3,ZB4 dhe te ZB5 kanë të drejtë me shfrytëzu bonusin.Drejtor tregom a është diskriminim për një pronar të pronës që i lejohet ndërtimi ZB3,ku mundësi te një objekti që është 15 m me i dhënë një kat?

Visar Kuçi - nuk është diskriminim.Drejtori jep sqarime sa i përket pyetjes.

Sanie Kuçi Rexhepaj - the që ka raste që nuk na nevojitet me u rrit ajo lartësi maksimale e HZK-së mirëpo ka me pas raste edhe që ka me pas nevojë me u rrit dhe në ato raste kur ka me pas nevojë me u rrit,ti ke me pas një hendikep brenda për brenda rregullores.Andaj propozimi jonë është ai 10% me u largu prej rregullores.Është e vërtetë që tërheqja e vijës ndërtimore parashihet edhe me norma edhe me HZK por s'ka logjikë me përfshi brenda për brenda kësaj rregullore.Po të lejohet ligjërisht por është e pakuptimtë në kontekst urban sepse krijon kaos urbanistik.The që komisioni e ka përfundu punën e vet,por jo drejtor,komisioni e përfundon punën e vet kur të miratohet kjo rregullore në Kuvend dhe deri sa nuk miratohet ajo rregullore,komisioni duhet me qenë aktiv për me i përmirësu të gjitha rekomandimet që dalin në kuvend ,e jo vetëm nga shqyrtimi publik.

Visar Kuçi - edhe unë m'u pyet,te vija ndërtimore nuk lejoj as 7.99 sepse e ruajmë atë vijën 8 metra por shkojmë në lartësinë në katet e fundit.Jo çdo herë ka me përfitu të gjitha bonuset investitore sepse sa më shumë sipërfaqe që i merret,atëherë ne jemi të obliguar me i dhënë deri në 4 bonuse.Drejtori tutje jep sqarime edhe me shembuj konkret.

Flamur Bytyçi - ekspertat mbledhjen e kaluar ishin pa përgadit dhe s'ju punojke as llaptopi e as nuk mujshim ne me pas një sqarim prej tyre.Nëse ju vërtetë jeni të interesuar për me kalu kjo çështje,ne mujna me kry sot.Nuk po të kuptoj ty e as Kryetarin që nuk është prezent këtu. Nëse don

me kalu, futni këto dy kërkesa që i kemi ne dhe e kalojmë. Nëse kish qenë aq interes i juaji për me kalu, ju na kishit ftu. Te përbërja e komisionit, pse është aq problem për ekzekutivin me qenë një anëtar prej kuvendit këtu?

Visar Kuçi - në cilat pika po kërkon ndryshim?

Flamur Bytyqi - unë nga dita e parë kam kërku që me qenë një përfaqësues i Kuvendi në komision përndryshe unë nuk votoj një diçka për deri sa nuk kemi përfaqësim në si asambleist. Dua të di çka po fshihet këtu?

Visar Kuçi - nëse pyetem unë, jo vetëm një anëtar por ne kemi qef krejt anëtarët e komisionit me qenë të asamblesë sepse përgjegjësia është e asamblesë. Le të gjenden njerëz profesionit por pjesën ligjore e sqaron ndoshta zyrtari ligjor.

Flmur Bytyqi - Selmani të dha sqarime se cilat propozime i ka. Bëji këto dyja dhe ne po e kalojmë.

Visar Kuçi - është pjesë e normës dhe as ne s'mund të bëjmë çka dojmë.

Kushtrim Kuçi - Sikur të na kish thirr Visari dhe këtë bisedë me bë pa media, në mënyrë shoqërore dhe gjithëashtu edhe ekipi të ishte i pranishëm, ish zgjidh kjo çështje. Të gjitha vërejtjet Visari i sqaro. Qëllimi jonë nuk është me gjet vërejtje por thjesht këtë rregullore me bë sa më të mire për qytetarët dhe bizneset. Unë punoj me këtë punë dhe as Visari dhe asnjë zyrtar komunal nuk ka leju me shkel vijën e ndërtimit.

Alban Berisha - është njëra prej vërejtjeve që e kam bë shpesh dhe prap do ta bëj sot. Pse mos me ardhë te ne si koncept, si draft në njërin prej këtyre etapave ku ne faktikisht çdo akt që nxirret prej këtij kuvendi e mban vulën e këtyre anëtarëve që jemi këtu. Kur thua Visar që është çështje e mbyllur, atëherë nëse është e mbyllur, pse e ke sjell? Vazhdone dhe zbatone rregulloren. Nuk shkon me prur rregullore për me miratu në stilin e vendimit të Kryetarit për me zbatu ai çka po don, por me miratimin e asambleistave. Që 8 vite është i njejt problem. Stili merre ose leje është shumë jo demokratikë dhe ky din me prodhu konflikte të panevojshme siç janë kriju që disa vite, duke ia nis prej themelimit të teatrit.

Urim Suka - u tha që LDK-ja mire që ka ardhë me propozime konkrete. Prej ditës së par kemi ardhë me propozime konkrete. Janë 2 propozime, një propozim i ekzekutivit dhe propozimi tjetër me ndryshimet dhe plotësimet që ne po i kërkojmë. Lus Kryesuesin ti hedh në votim.

Dardan Berisha - sa i përket anës përmbajtësore ne e kemi diskutu. Realisht po merr kahje politike kjo rregullore. Ajo që më shqetëson mua, është që këtu po kërkohet që patjetër kuvendi me qenë pjesë e komisionit. Mua më kujtohet shumë mire që këtë legjislaturë kur ekzekutivi ka kërku me formu një komision i cili i rishikon të gjitha kontratat e bizneseve dhe aktivitetin e biznese që e shfrytëzojnë zonën ekonomike në Shirokë, asnjëri prej nesh nuk kemi pas vullnet me hy në atë komision që realisht ne biem në kundërshtim me vetveten te pika e fundit. Sa i përket kolegëve që diskutuan, unë mund të pajtohem për shumë pika por kjo çështja pse unë nuk jam anëtar i komisionit, mua më duket që po e banalizojmë pak.

Flamur Bytyqi - çështjen që po e përmend ti, ka dallim shumë sepse tash po nxerret një rregullore dhe për çështjen për të cilën po flet ti, menaxhimin e kontratave e ka zyra e Kryetarit. Unë nuk po kërkoj për vete por po kërkoj që dikush prej Asamblesë me qenë pjesë e komisionit.

Dardan Berisha - kjo është tema që është diskutu më së shumti, për anën e komisionit. Unë e thash që ta heqim këtë pjesë dhe ti japim rëndësi arsyeve profesionale. Këtë kontratë nëse ne e kalojmë, kush duhet ta nënshkruaj? Këtë duhet ta nënshkruaj Kryetari.

Visar Kuçi - po marr shumë mesazhe prej qytetarëve dhe prej bizneseve ku nuk është e qartë puna e konfliktit të interesit. A ka konflikt një asambleist këtu në këtë rregullore nëse votohet? Kërkoj sqarime nga zyrtari ligjor.

Avni Bytyqi - anëtari, zyrtari i lartë publik sipas ligjit për vetqeverisje lokale, sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit, është i obliguar vet me paraqit konfliktin e interesit, atëherë e shqyrtojmë mundësinë ligjore se a paraqet konflikt interesi apo nuk paraqet konflikt interesi. Liridoni bëri pyetjen e tha: nëse ka lidhje me biznesin, i cili ka të nënshkruar ndonjë kontratë për ndërtimin e objektit në parcellën e tij? dhe unë dyshoj që ka konflikt interesi. Kur ai nuk bindet që ka konflikt interesi, është agjensioni për parandalimin e konfliktit të interesit i cili merr vendim dhe e orienton se çka me vepru.

Mevlud Kabashi - është e treta sencë që kjo pike po vje në rend dite. Po du t'ia rikujtoj z. Kuçi që në fund të takimit të seancës së kaluar na ka ftu në një takim, në një rishikim të këtyre pikave me bashkëpunu, m'ia përmirësu dhe prap me ardhë në seancë. Atë ditë kam fol por atë ditë nuk u dëgju

zëri im sepse mikrofonat nuk kanë bërë dhe edhe sot mikrofonat nuk po bëjnë. Pse nuk na ke ftu Visar? Mos me na prurë kot në këtë nxehtë dhe pa klimë, me hupë saq kohë për një pikë kur ka qenë saq e rëndësishme për ty si drejtor, për biznese dhe unë mbi të gjitha shpresoj që do të jetë e rëndësishme për qytetarët sepse ne për këtë punë jemi.

Visar Kuçi - është fakt që unë atë ditë i kam premtu Flamurit, që unë jam në gjendje me ju ftu dhe me ju sqaru këtë pjesën që e sqarova sot. E keqkuptuat atë që thashë që komisioni e ka përfunduar pjesën e vet. E ka përfunduar pjesën e vet deri në Asamblë por edhe një herë mund të kthehet në pikën zero. Unë atë ditë jam kanë në gjendje me sqaru këtë por pasi ka ardhë kërkesa të Kryesuesit dhe të Kryetarit të komunës prej 21 bizneseve, Kryetari dhe Kryesuesi e kanë pa të arsyeshme me sjell.

Mevlud Kabashi - atë ditë drejtor unë kam kërku sqarim prej teje sepse nuk jam eksperte e fushës dhe beso që nuk jam kanë as për po e as për jo. Atë ditë ti nuk e ke marrë mundimin me dhanë sqarime. Kjo i bie injorim ndaj një asambleiste ose asambleisti.

Visar Kuçi - atë ditë ti ke kërku sqarim për Planin Rregullues Duhël. Nuk e kam sjell më. Nuk ka qu peshë më për mua me sjell një draft pa mbajtë edhe konsultime tjera publike. Drejtori tutje jep sqarime.

Aziz Bytyqi - nuk jam profesionist i kësaj fushe. U bë një debat tekniko-profesional. Dua ta konstatoj se vullneti është me kalu ky dokument. Është inters i bizneseve, i qytetarëve dhe i të gjithëve. Për deri sa është ky vullnet, unë ju kisha propozu juve që jeni profesionist, të uleni dhe pikat që janë të mundshme m'u ndryshu.

Urim Suka - thirrja e Visarit të kish ndodh, i gjithë ky debat sot do të ishte konsumu me atë takim. Tash janë dy rrugë, ose të votohen një nga një dy propozimet ose me lane një seancë tjetër dhe me u mbledh ekspertat dhe me pa çka mujnë me harmonizu. Visari tha: unë nuk ju kam thirr sepse kanë bërë kërkesë 21 biznese. Por kur kanë bërë kërkesë ato 21 biznese, ti për atë u dasht me thirr, me diskutu, me harmonizu dhe me u votu sot rregullorja.

Kryesuesi - ne e kemi obligim që ta hedhim në votim dhe në qoftëse kalon është në rregull dhe në qoftëse nuk kalon mbetet në diskutacionin e grupit punues me ju thirr juve, me diskutu, me hartu edhe një herë dhe me vendos në dëgjim publik dhe me vazhdu.

Shefket Kolgeci - grupi jonë parlamentar i dhamë vërejtjet dhe sugjerimet. Ose merrni vërejtjet dhe sugjerimet tona dhe inkorporoni, ose hedhni propozimet në votim. Nëse kalon propozimi juaj, në rregull por nëse nuk kalon, duhet ta hedhni në votim propozimin tone.

Kryesuesi - nuk është problem por nuk e di a më lejohet kjo.

Saranda Bajraktari - pyetje për zyrтарin ligjor: a kemi të drejtë me dhënë rekomandime të tilla që i kemi nga ekspertë të fushës dhe me kalu rregullorja me ndryshimet e propozuara nga Kuvendi?

Avni Bytyqi - Kuvendi është organi vendimmarrës. Në këtë rast Kryesuesi i Kuvendit e ka në diskrecion që ti hedhë në votim propozimet ashtu siq i kanë ardhë dhe propozimet që dalin nga Kuvendi. Propozimi i parë është të hedhet në votim rregullorja ashtu siq e ka propozu ekzekutivi. Propozimi i dytë është që të hedhet në votim ashtu siq po propozojnë pjesa tjetër e anëtarëve të Kuvendit mirëpo mendimi im profesional është që të mos shkojmë në këtë formë sepse nuk është çështje teknike edhe shtimi i dy fjalëve apo tri fjalëve por është gati 40% e plotësim-ndryshimit të kësaj rregullore e që unë mendoj dhe vlerësoj që duhet të kthehet kjo rregullore prap, të diskutohet me grupin punues, ta caktojmë një takim me njerëz ekspertë që i dhanë këto rekomandime dhe këto sugjerime, ti inkorporojmë në rregullore ashtu siq e kërkon ligji dhe rregulloret në fuqi dhe të vazhdojmë me procedurën e miratimit, me kompromisin e të gjithë anëtarëve të Kuvendit të cilët i japin vërejtjet dhe rekomandimet e tyre në këtë rregullore. Zyrтарi ligjor tutje jep sqarime.

Visar Kuçi - sot nëse miratohet kjo rregullore, në të ardhmen e mund të pësoj plotësim-ndryshim?

Avni Bytyqi - ligji i jep mundësinë kuvendit çdo herë kur ka nevojë me propozimin e propozuesit të parë dhe me propozimin e një të tretës të anëtarëve të Kuvendit që të bëhet plotësim-ndryshimi i çdo akti të Kuvendit që miratohet në Kuvend.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

13 për, 14 kundër, 1 apstenim, Nuk Miratohet pika 4

Pika 5. Informatë për administrimin e buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar-qershor 2025 ;

Kryesuesi - e hap debatin për këtë pikë.

Labinot Halitjaha - buxheti komunal i Suharekës për të gjitha kategoritë për vitin 2025 është 24.132.000, prej tyre janë të alokuara 70.187.000, 4.226.000 janë nga 10-tëshi dhe pjesa tjetër është nga vetanaket. Të hyrat vetanake gjatë këtij 6 mujori janë 1.083.000€ pa denimet e gjykatave dhe të trafikut ndërsa me ato arrin vlerën afërsisht 1.440.000. Shpenzimi i buxhetit gjatë këtij 6 mujori ka shku deri në 62.42%.

Urim Suka - te pjesa e investimeve kapitale po figuron që janë shpenzu 28.74% ose 1.803.000€ afërsisht. Ky 1.8 milion, sa prej kësaj vlere është që janë marrë nga gjykata? Sepse ju nuk po i ndani dhe në raport po figurojnë si të shpenzuara 1.803.000€ por unë e di që këtu ka edhe pjesë që i kanë marrë përmbaruesit për shkak të kontratave kolektive.

Labinot Halitjaha - ZKF në KPF ka dhënë sqarime për këtë temë dhe kemi diskutu që në Asamble mi sjell të gjitha projektet se ku i ka marrë përmbaruesi dhe ZKF do ti sqaron ato që i ka në sistem.

Liridon Fandaj - deri me 30 qershor janë realizu vetëm 28.74% e buxhetit për projekte kapitale. Disa nga projektet figurojnë me zero shpenzim si: Ndërtimi rrugëve lokale në shumë fshatra nuk ka fillu fare; Impianti për ujëra të zeza në Sllapuzhan dhe Dubravë ka 6 muaj që nuk ka fillu; Blerja e autofshesës 180.000€; Pse nuk janë nis këto projekte në 6 mujorin e parë dhe a ka vonesa në procedura apo mungesë gadishmërie për zbatim? Fondi vetanak 21 vetëm 36.75% e shpenzimeve të planifikuara; Fond i bartun 22 vetëm 34.36 e shpenzimeve; Edhe pse janë inkasu 1.1 milion euro deri në maj, një pjesë e mbetur e pa shfrytëzuar dhe e pa planifikuar mirë. Drejtori duhet të paraqes një plan të ri për aktivizimin e këtyre mjeteve deri në fund të gushtit. Një tepriçë e lartë e paarsyetuar e buxhetit prej 6.8 milion euro që është shenjë e mos realizimit dhe mungesës së efikasitetit të menaxhimit. A është kjo pasojë e mungesës së kontratave të nënshkruara me vonesë apo paaftësi e prokurimit për me vazhdu me këto projekte? Janë disa projekte që në raport nuk arsyetohen, p.sh. projekti i palestrës në Peqan ku aty shkruan që mjetet janë shpenzu por në raport nuk ka sqarim. Ne edhe në 3 mujor e kemi diskutu që të paktën t'na jepet një arsyetim që këto mjete edhe pse janë të evidentuara në tabela por ta kemi të shkruar arsyetimin se çka ka ndodh.

Subvencione për etnitete publike janë 173.200, 70.326 dhe 55.500 dhe te pagesat për përfituesit individual janë 83.900 dhe 175.350. Ku kanë shku këto mjete?

Fadil Hoxha - totali i vendimit të gjykatave deri më 31.06. që janë të ekzekutuara është 1,069,017.82€. Komunalit janë marrë 1.262.000€; mallra dhe shërbime janë 356,778.78€; subvencione janë 78,470.39€ dhe shpenzime kapitale 632,506.65€. ZKF elaboron nëpër secilën drejtori se ku janë marrë mjete prej vendimeve të gjykatave.

Liridon Fandaj - te subvencionet për etnitete publike çka përmban ai kod?

Fadil Hoxha - etnitet epublike konsiderohen të gjitha shoqatat, klubet sportive dhe OJQ-të. Te pagesat për përfitues individual, këto janë të ndryshme dhe janë me emra. Ka që edhe ju i keni aprovu aso vendime të cilat janë me emra.

Liridon Fandaj - ne i kemi miratu këto por pak a shumë me ma dhënë një sqarim sepse nëse thotë individ, ne i kemi ndihmu por nuk janë vlera aq të mëdha.

Fadil Hoxha - ky është totali i shpenzimit. Vetëm i kërkon te cila njesi buxhetore dhe në seancën tjetër i nxjerr në mënyrë analitike dhe i përcjelli.

Pika 6. Raporti i parë gjashtëmujor për mbikqyrjen e kontratave të pronës;

Kryesuesi - elaboron pikën dhe hap debatin.

Flamur Bytyçi - me mirëkuptin tuaj kisha kërku që kjo pikë me u shty për seancën e ardhshme për shkak që edhe materiali na ka ardhë me vonesë dhe me na lënë kohë me shtjellu materialin.

Kryesuesi - për me tërheq pikën duhet ta hedhim në votim por nuk kemi kuorum. Me ndërpre, duhet me thirr seancë tjetër për këtë pikë.

Avni Bytyqi - ligji decidivisht e thotë që para çdo procesi të vendimmarrjes duhet të konstatohet kuorumi. Pasi është njoftim ne mund ta diskutojmë por sikur të kishim me marrë vendim, ne është dasht ta ndërprejmë menjëherë seancën.

Urim Suka - në këtë rast, a e kemi zotimin e drejtorit dhe të Kryesuesit që në seancën e radhës e sjell si propozim.

Pika 7. Pyetje dhe përgjigje;

Shyqerie Zyrapi - a është bërë ndryshimi i projektit në hapjen e dritareve në shkollën “Kongresi i Manastirit” pasi hapja e dritareve nga posht rrezikon sigurinë e nxënësve? Kërkojmë që hapja e dritareve në pjesën e poshtme të bëhet e njëjtë siq ka qenë (kiper) dhe për pjesën e lartë të dritareve, të hapen normal dhe gjithëashtu rregullimi i oborrit të shkollës. Pse nuk është bërë rregullimi i ndriçimit të sheshi “Besim Ndreca” dhe çka është bërë me segmentin të rruga “Dëshmori i lirisë”, të shtëpia e Arsim Gegës?

Enver Shabani - ndriçimi publik të sheshi Besim Ndreca nuk është rregullu por jemi në proces kurse sa i përket rrugës “Arsim Gega” segment, veq tani më e kemi zgjidh si problem dhe është aprovu kërkesa juaj sepse ka pas disa gabime teknike.

Selman Kolgeci - e kam ngrit disa herë çështjen e pahive elastike. I ke së paku tri kontrata të mirëmbajtjes verore në të cilat e ke edhe pozicionin e pahive elastike të përfshinë në kontratë. Të lutem urgjent merri dhe vendosi pahitë elastike. Që dy herë kemi shpët për shkak se kanë ndodh dy aksidente, një vitin e kaluar ka ndodh dhe një pardje ka ndodh. Tjetër është kanalizimi të rruga “Vudro Vilson” ku kam marrë një ankesë prej qytetarëve për shkak të diametrit të ulët. A ka projekt ky kanalizim? Nëse po, a është trajtu numri i njesive të banimit në mënyrë që në të ardhmen mos me pas tellashe?

Enver Shabani - ne disa here kemi bërë kërkesë me shkrim në Ministrinë e Infrastruktura të na ndihmojnë në këtë projekt sepse ne si komunë nuk kemi buxhet të ndarë për këtë projekt. E kemi një kontratë verore dhe unë nuk di që ka ndonjë pozicion për pahi elastike por do ta marrë përsipër me studiu edhe një here në tërësi si kontratë dhe m’i shiku pozicionet e pahive elastike. Nëse na mundëson kontrata në këtë rast që duhet me pas së paku në pozicion dy metra, ne do ta bëjmë të tërën si njesi mbrojtëse. Për kanalizim është një firmë projektuese që ka bërë studim dhe fizibilitet, na ka sjell projekt të gatshëm dhe kemi fillu me ekzekutimin e projektit. Këto kërkesa nuk na kanë ardhë në zyrën tone në formë zyrtare.

Selman Kolgeci - Te çështja e pare nuk bëhet fjalë për 100.000€ por bëhet fjalë për 15.000-20.000€. Te kanalizimi, unë e shpreha si shqetësim sepse më erdh si shqetësim dhe mora shkas me ngrit si temë për shkak se nëse po bëhet një diçka sot që nuk është analizu, pse nuk po e analizojmë në këtë fazë sa jemi duke e punu. Te çështja e sinjalizimit ta kam thënë dhe tu kam drejtu edhe ty dhe Kryetarit me email dhe ju kam gjet se cili pozicion është pahi elastike. Janë tri kontrata që kanë shku deri tash dhe nuk është ekzekutu ky pozicion.

Kryesuesi - po kyqem te kanalizimi. Është problemi që ai kanalizim kur është ndërtu viteve ’81 edhe i njëjti kanalizim ka qenë mirëpo tash është rrit kapaciteti dhe nuk po e përmban ai kanalizim. Kanë dal inxhinierat, kanë bërë matjen dhe fizibilitet të rrugës dhe ata kanë ardhë në përfundim që kanalizimi duhet me pas derdhjen të ballkani. Sa kam informacione, e ka lejen e punës. Te diametri edhe unë të njëjtin mendim e ndaj.

Enver Shabani - Selman të lus miqësisht ta bësh një paramasë për pahi elastike. Nuk kemi kod për pahi por do ta qojmë një buxhet ose nëse s’ke mundësi, do të merremi ne me zyrtarët ose inxhinierët tonë që i kemi dhe do ta trajtojmë seriozisht.

Selman Kolgeci - unë e marrë përsipër me përpilu një paramasë për hir të qytetarëve.

Urim Suka - unë e kam një shqetësim që lidhet me kanalizimin që ngriti Selmani por shqetësimi im është i natyrës tjetër ku mua njerëzit aty m’u kanë anku që po vjen kanalizimi por disa banorë që janë aty nuk mund të qasen.

Kryesuesi - faktikisht, aty që unë i kam përcjell, shumica janë kyq. Fillon të ETC-ja dhe përfundon me rrugës Vudro Vilson.

Liridon Fandaj - rruga “Ali Zogaj” në Javor ka qenë e planifikuar në vitin 2024. A u shtru ajo rrugë dhe nëse u shtru, si ka mundësi që tash prap ka dal në tender e njëjta rrugë? Një kërkesë e kam pas prej banorëve të fshatit Maqitevë dhe t’u kam adresu edhe në Asamble dhe t’kam thirr privatisht për punën e një muri që tash vetëm është rrëzu por atëherë të kam paralajmëru që është keq por fatmirësisht s’ka pas fatkeqësi. A keni shku në vendngjarje me pa? Sepse aty për shkak të atij muri edhe rruga që është e shtruar, nesër edhe ajo rrugë ka me ra prap aty sepse është pozicion i keq.

Enver Shabani - rruga “Ali Zogaj” në Javor vitin e kaluar nuk është përfunduar. Jemi në procedure të prokurimit dhe këtë vit do të shtrohet. Një mur që unë kam informata që është i rrënuar, ku jemi duke e rregulluar një rrugë aktualisht, ai mur nuk ka me u ndërtuar për arsye të mungesës së buxhetit dhe megjithëatë është pronë private edhe pse ai nuk po pengon. Nëse vlerëson një rrezik ekspertë të fushave ndoshta e detyron komunën me një kod të veçantë por aktualisht nuk kemi ndonjë fond.

Liridon Fandaj - nëse një rrugë është e shtruar aty, është më mire me gjet mundësinë dhe me bo një mur aty se sa me i bë dy investime të njëjtën kohë. Te rruga Ali Zogaj, nuk është e planifikuar këtë vit dhe nuk di si tenderohet.

Enver Shabani - rrugët që kanë qenë të pa rregulluara dhe që kemi pas mundësi me i bartë, i kemi bart këtë vit. Sa i përket mureve komuna e Suharekës nuk ka shumë mundësi financiare me rregullu mure nëpër shtëpia dhe oborre private. Jemi duke e rregulluar një mur mbrojtës në shtratin e lumit Toplluha në Suharekë.

Liridon Fandaj - unë të kuptoj por aty shkaktohet një dëm më i madh. Nëse ti nuk e rregullon atë, ti ke mi bë dy investime. Te pjesa e Toplluhës, është investim i ministrisë.

Enver Shabani - të gjitha mjetet që i disponon dhe i menaxhon komuna janë nga qeveria, vetëm disa të hyra vetanake janë tonat. Nëse vijnë prioritet nga fshati ne jemi të gatshëm.

Takimi përfundoi: 13:10

Procesmbajtësja: Dafina Haziraj